



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2021

PËR

DISA SHTESA NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, “Llojet e taksave kombëtare”, shtohen pikat 12 deri 16, me këtë përmbajtje:

- “12. Taksë për qumështin pluhur për tregti (i përfshirë në kreun 0402 të NKM-së).
13. Taksë për pijen e homogjenizuar barista (i përfshirë në kreun 0404 të NKM-së).
14. Taksë për hurrë qumështi (i përfshirë në kreun 0404 të NKM-së).
15. Taksë për krem qumështi (i përfshirë në kreun 0402 të NKM-së).

16. Taksë për karburantin në zonat e lira doganore dhe magazinat doganore, që përdoret për furnizimin e mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim, të përcaktuara sipas ligjit “Për aktivitetet e turizmit detar.”.

Neni 2

Në nenin 4, “Niveli i taksave kombëtare”, shtohen pikat 12 deri 16, me këtë përmbajtje:

- “12. Taksa për qumështin pluhur është në vlerën 100 lekë për kg.
13. Taksa për pijen e homogjenizuar barista është në vlerën 16 lekë për litër.
14. Taksa për hurrë qumështi është në vlerën 150 lekë për kg.
15. Taksa për krem qumështi është në vlerën 150 lekë për litër.
16. Taksa për karburantin në zonat e lira doganore dhe magazinat doganore, që përdoret për furnizimin e mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim, të përcaktuara sipas ligjit “Për aktivitetet e turizmit detar”, është në vlerën 65 lekë/litri.”.

Neni 3

Në nenin 5, “Agjentët e taksave”, shtohen shkronjat “h” deri “l”, me këtë përmbajtje:

- “h)për taksën e importimit të qumështit pluhur, organet doganore;
- i) për taksën për pijen e homogjenizuar barista, organet doganore ;
- j) për taksën për hurrë qumështi, organet doganore;
- k)për taksën për krem qumështi, organet doganore;
- l)për taksën për karburantin në zonat e lira doganore dhe magazinat doganore, që përdoret për furnizimin e mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim, organet doganore.”.

Neni 4

Në nenin 9 “Përrjashtimet nga pagimi i taksave kombëtare”, shtohet pika 8, me këtë përmbajtje:

- “8. Përrjashtohen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hurrë qumështi dhe taksës për krem qumështi fabrikat e prodhimit me etiketë të miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA